



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

Numri i lëndës: 2022:005598

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 05943979

PPP.nr.30/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha-Ramani, në çështjen juridike të përmbarrimit sipas propozimit për përmbarrim të kreditorës I me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.M nga Rahoveci, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhërit të përmbarruesit privat D.B në Prishtinë, P.nr.405/17 të datës 30.06.2017, me datë 16.07.2024 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I.REFUZOHET në tërësi prapësimi i debitorit N.M nga Rahoveci p.nr, i paraqitur kundër urdhërit të përmbarruesit privat, D.B nga Prishtina, P.nr.405/17 të datës 30.06.2017, në tërësi si i pabazuar.

II.MBETET NË FUQI urdhri i përmbarruesit privat D.B në Prishtinë, P.nr.405/17 të datës 30.06.2017, me të cilin është caktuar përmbarrimi për borxhin në shumë prej 154.19 Euro në emër të borxhit, me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së propozimit (data 30.06.20217) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

**A r s y e t i m**

Sipas propozimit të kreditorës Ime seli në Prishtinë, përmbarruesi privat D.B në Prishtinë, ka lejuar përmbarrimin sipas urdhërit P.nr.405/17 të datës 30.06.2017, në bazë të dokumentit besueshëm faturës, kundër debitorit H.Sh nga Rahoveci, për shkak të borxhit në emër të shërbimeve të kombinuara në shumën e përgjithshme prej 154.19 Euro.

Kundër urdhërit me të cilin është caktuar përmbarrimi, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kontestuar urdhërin, përmes të cilit ka deklaruar se shpenzimet

në lartësin e kërkuar nuk është e vërtetë që i ka shkaktuar debitori dhe se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 30 par.2 i LPP, sepse debitori fare nuk e ka shfrytëzuar internetin e sidomos telefonin dhe se për këto pretendime ka paraqitur edhe ankesë pranë qendrës së I-së, në Prishtinë. Injëjti ka kundërshtuar edhe lejimin e kamatës së paraqitur nga kreditori. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë prapësimin dhe ta shfuqizojë urdhërin e përmbaruesit privat.

Kreditorja brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazë, pasi që nuk përmban asnjë nga shkaqet e parapara në enin 71 të LPP-së, me arsyetimin se debitori nuk ka parashtruar asnjë provë me të cilin do të kontestoi borxhin në shumën prej 154.19 euro, dhe nuk ka mbështetje në asnjë provë që të kontestoi dokumentin e besueshëm të paraparë me neni 29 par.1 pika 1,2 të LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditores, urdhërit për lejimin e përmbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditores, shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.3 të dt.31.01.2013, më tej LPP) në nenin 21 përcaktohen bazat juridike për caktimin e përmbarimit, *”Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa me nenin 29 par.1 nënpar.1.3 përcaktohet se *” Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. faturat; ”*

Gjykata me analizimin e propozimit për përmbarim P.nr.405/17 të datës 30.06.2017, faturës nr.00550687 datë 25.04.2016, faturës nr.0570318 datë 25.05.2016 dhe faturës nr.0598445 datë 25.05.2016, ka ardhur në përfundim se debitori në emër të shërbimeve të kombinuara ndaj kreditores ka krijuar borxh shumën prej 154.19 euro. Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi që ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitores dhe ta lë në fuqi urdhërin e përmbaruesit privat, duke u bazuar edhe në LPP nenin 29 par.1 nënpar 1.3 dhe 3, ku ndër të tjera është cekur: *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji, janë 1.3. faturat dhe se Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe së në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së. Debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova, sipas nenit 69 par. 4 të LPP-së, i cili parasheh që *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, për ndryshe prapësimi do të refuzohet”*.

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi lidhur me kumatën ligjor prej 8% konform nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi sipas arsytimit të përshkruar më lartë, duke u mbështetur edhe në dispozitat ligjore: nenin 29 par. 1 nënpar.2 dhe 3 lidhur me nenin 73 dhe nenin 77 par.1 dhe 5 të LPP-së, nenin 341 par.1, 360 par.1 dhe 2 dhe nenin 368 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
PPP.nr.30/2020, me datë 16.07.2024.

Gj y q t a r i  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate Themelore.